

Tryeza e rrumbullakët

IDENTIFIKIMI DHE MANIPULIMI ME DISKURSIN PUBLIK POLARIZUES: DILEMA ETIKE DHE PRAKTIKE

20 janar 2020, ora 12, hoteli "Sollun", Shkup

HYRJE TEORETIKE

(Pjesë nga Analiza "Diskursi polarizues dhe ndikimi mbi politikën dhe polarizimin social në shoqërinë e Maqedonisë")

Kuptimi më i gjërë i polarizimit ka të bëjë me qëndrimet e kundërshtuara në lidhje me çështje të përcaktuara politike dhe shoqërore të cilat janë ekskluzive dhe të papajtueshme. Polarizimi politik, nga ana tjetër, mund të burojë nga identifikimi jokritik dhe/ose i fantazuar me parti politike dhe/ose ideologji.

Polarizimi gjithashtu mund të kuptohet si një situatë me ndarje të lartë në sferën publike që paraqitet përmes diskursit antagornizues që e formon diskursin publik dhe interakcionin social përmes dy pozitave antagornizuese.

Analizat dhe hulumtimet e mëparshme që i shqyrtoi Instituti i shkencave shoqërore dhe humanistike – Shkup, tregojnë se polarizimi është i lidhur me krizën e vlerave liberale që janë të rrënjosura në shoqëritë demokratike bashkëkohore.

Ndër faktorët e shumtë të cilat ndikojnë në polarizimin, nga më të përmendurit janë mediat dhe ndikimi i tyre mbi polarizimin. Pranë mediave klasike, zmadhimi i ndikimit në rrjetet sociale, gjithashtu paraqitet si faktor i diskursit polarizues. Autorët të cilat e hulumtojnë aspektin mediatik të polarizimit vërejnë se përdorimi i zmadhuar i rrjeteve shoqërore zmadhon polarizimin, duke e sqaruar këtë fenomen përmes krijimit të "eho komorave" në të cilat njerzit mbeten në rrethin e tyre shoqëror, dhe kjo kontribuon për këmbim pothuajse vetëm me bashkëmendimtarët. Në fund izolimet e këtilla i përforcojnë paragjykimet dhe e zmadhojnë distancën. Distanca, veçanërisht në internet hapsirën ku depersonalizimi është edhe më i madh, mund të përforcohet dhe të zmadhohet kushtet për shprehje të afekteve të zemërimit dhe urrejtjes përmes të folurit.

Fjalimi polarizues çdoher ka komponentë emocionale, përmes ndienjës së përkatësisë dhe besnikërisë kah grupi social që mund të jetë edhe partia politike. Komponenta emocionale e fjalimit polarizues e bën që të kontribuojë për zgjerimin e tensioneve midis grupeve të kundërshtuara, por gjithashtu edhe përkah zmadhimet e mundësive të disonancës kognitive. Kjo nënkupton prirje për mospranimin e fakteve dhe të dhënave të cilat janë të kundërta për besimet që i kemi apo interpretimet e tyre të ndryshme.

Përmes insistimit të dallimeve dhe pozicionimi i kundërshtueshëm, me polarizimin krijohet distanca e cila mundëson proekcionet emocionale, ose atribuimi i karakteristikave, qëllimeve etj. i të tjerëve si mekanizëm mbrojtës nga qëllimet tona, karakteristika të cilat nuk jemi të përgaditur që ti pranojmë. Antagonizmi dhe distanca kontribuojnë përkah zvogëlimin e mundësisë për apati dhe kushte për zmadhim të urrejtjes. Komponenta emocionale e polarizimit është më e shprehur kur bëhet fjalë për ndienjën e sigurisë, mbijetesës apo për përkatësi ose identitet dhe kur lidhja midis identitet është e fuqishme, kurse situacioni përjetohet si kërcënues në lidhje me këtë identitet. Pastaj, mund të referohet ndienjës për drejtësi/padrechtësi dhe të pranimit/hedhjes dhe vlerësimit të përcaktuar të vlerës/nënçmimit.

Në situata kur ndienja dominante të cilat janë të nxitura me fjalimin janë frika, turpi dhe zemërimi, është shumë më lehtë që zemërimi të shprehet për ata të cilat përjetohen si të "tjerë", të "largët", "armiç". Zemërimi mund të shprehet përmes fjalimit të urrejtjes ose me forma të tjera të dhunës psikologjike ose fizike.

(më shumë në <http://www.isshs.edu.mk/поларизирачкиот-дискурс-и-влијаниет/?lang=mk>)